

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2) dhe nenit 30 paragrafi (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në përbërje: Mr. Borçe Razmoski – kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgačevski dhe Nikolla Trajčevski – anëtarë, duke vepruar në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare, me konkluzionin PK.nr.09-9/1 të datës 02.02.2023, kundër ISHP-Laboratori për diagnostikim molekular Laor Tetovë, me seli në rr. "29 Nëntori" nr. 21-1 Përdhes/Lok1, 2 dhe 3, Tetovë, i përfaqësuar nga i autorizuari Avokat Trajçe Sazdov, dhe për shkak të kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më 05.03.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare, me konkluzionin Pk.nr.09-9/1 të datës 02.02.2023, kundër ISHP-Laboratori për diagnostikim molekular Laor Tetovë, me seli në rr. "29 Nëntori" nr. 21-1 Përdhes/Lok1, 2 dhe 3, Tetovë, me NUAS 7429371, NUT 4028020540679, llogaria rrjedhëse nr. 200003579453737 në Stopanska Banka SH.A. Shkup, i përfaqësuar nga i autorizuari Avokat Trajçe Sazdov, për shkak të dorëzimit të të dhënave jo të plota të cilat mund ta sjellin në lajthitje Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës ose Komisionin për Vendimmarrje për Kundërvajtje, **KVK konstatoi se ISHP - Laboratori për diagnostikim molekular Laor Tetovë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Për kundërvajtjen e kryer nga pika 1 e këtij aktvendimi, **kryerësit:**

-ISHP-Laboratori për diagnostikim molekular Laor Tetovë, i shqiptohet gjobë në shumë prej 60.000,00 denarë, që paraqet përafërsisht 0.26% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të ISHP-Laboratori për diagnostikim molekular Laor Tetovë të realizuara në vitin 2023, si viti i fundit afarist për të cilin ndërmarrja ka përpiluar llogari vjetore.

3. Gjobën nga pika 2 e këtij aktvendimi, kryerësi i kundërvajtjes është i detyruar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit në llogarinë e transaksionit të marrësit të pagesës: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx¹07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifër të të ardhurave 722139 dhe program 00, marrësi i pagesës - Ministria e Financave, banka e marrësit – BPRMV dhe deri te Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë dëshmi/kopje nga pagesa e kryer e gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose gjoba e papaguar në kohë, do të arkëtohet me detyrim. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

¹ Shënohet shenja e komunës në përputhje me Listën e komunave me shenja në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e evidentimit, shpërndarjes dhe kthimit të të ardhurave publike (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 8/06).

Arsyetim

Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës me shkresën PK.nr.09-40/1 të datës 03.11.2022 deri te Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK), dorëzoi kërkesë, që KVK sipas detyrës zyrtare të iniciojë procedurë kundërvajtëse kundër ISHP-Laboratori për diagnostikim molekular "Laor" Tetovë (në tekstin e mëtejme: ISHP "Laor" Tetovë), rr. "29 Nëntori" nr. 21-1, Përdhes/Lok 1, 2 dhe 3, Tetovë, për shkak të dorëzimit të të dhënave jo të plota gjatë veprimit sipas konkluzionit PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe në kuptim të nenit 48 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: LMK), që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së.

Në kërkesë është theksuar se Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KMK), në pajtim me kompetencat ligjore, me konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 (i bashkëngjitur si provë ndaj kërkesës për iniciimin e procedurës) e ka obliguar ISHP Laor Tetovë, që deri te KMK t'i dorëzojë dokumentet dhe të dhënat në vijim:

- Të dhëna për testimet e bëra gjithsej për infeksion nga korona virusi COVID-19 veçmas sipas llojeve të testeve dhe veçmas në vitin 2020, 2021 dhe për periudhën janar – shkurt 2022;
- Kopje nga të gjitha çmimoret e miratuara për testime për infeksion nga korona virusi COVID-19 nga viti 2020 e këndej;
- Të hyrat e realizuara gjithsej nga testimet për infeksion nga korona virusi COVID-19 për vitin 2020, 2021 dhe për periudhën janar-shkurt 2022 veçmas dhe veçmas sipas llojeve të testeve;
- Nga kush janë kryer furnizimet e testeve për testim për infeksion nga korona virusi COVID-19.

Qëllimi i sigurimit të të dhënave ishte hulumtimi dhe konstatimi i gjendjeve në treg për ofrimin e shërbimeve të testimit për infeksion për korona virusin COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me shkresën nr. 07-29/20 të datës 15.04.2022, ISHP "Laor" Tetovë, përmes të autorizuarit të tij, avokatit Trajçe Sazdov, avokat për të cilin nuk është dorëzuar prokurë, ka dorëzuar përgjigje lidhur me konkluzionin në të cilin ka theksuar se:

- Në pjesën e testimeve nga korona virusi Covid-19 veçmas sipas llojeve të testeve në vitin 2020, 2021 dhe për periudhën 2022 nevojitet të saktësohet lloji i saktë i testeve që kryhen me kërkesë të pacientëve, dhe janë të lidhura me Covid-19, të cilat mund të jenë të llojit të ndryshëm dhe atë: PCR test për detektimin e SARS-CoV-2, test i shpejtë antigjen dhe detektimi i IgG dhe IgM nga gjaku kapilar, test i shpejtë për detektimin e antitropave;
- ISHP "Laor" Tetovë ka miratuar çmimore në pajtim me të cilat i ofron shërbimet shëndetësore dhe të cilat janë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive;

- Të hyrat e realizuara gjithsej të ISHP "Laor" Tetovë janë të dhëna publike të cilat mund të sigurohen nga Regjistri Qendror, si dhe të hyrat e realizuara lidhur me testimet për Covid-19, por se nuk ekziston mundësi që të ndahen për arsye se nga ana e pacientëve mund të kryhen shërbime të ndryshme shëndetësore dhe të njëjtat të paguhën në mënyrë të kompletuar d.m.th. në grup;
- Testet për testim për infeksion nga Covid-19, ISHP "Laor" Tetovë i furnizon nga shumica e depove farmaceutike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nga përgjigjja e theksuar lidhur me konkluzionin, KVK konstatoi se ISHP "Laor" Tetovë është përgjigjur jo plotësisht sipas konkluzionit PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 me të cilin i është kërkuar dorëzimi i të dhënave të kërkuara.

Respektivisht, edhe pse me konkluzionin qartë kërkohet të dorëzohen të dhëna për testimet e bëra gjithsej për infeksion nga korona virusi COVID-19 veçmas sipas llojeve të testeve dhe veçmas në vitin 2020, 2021 dhe për periudhën janar-shkurt 2022, ISHP "Laor" Tetovë nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, por thekson se nevojitet të saktësohet lloji i saktë i testeve që kryhen me kërkesë të pacientëve, dhe janë të lidhura me Covid-19, të cilat mund të jenë të llojit të ndryshëm. Sekretari i Përgjithshëm në konkluzion qartë kërkon të dorëzohen të dhëna për secilin lloj të veçantë të testit për infeksion nga korona virusi COVID-19.

Me konkluzionin pa mëdyshje kërkohet të dorëzohet kopje nga të gjitha çmimoret e miratuara për teste për infeksion nga korona virusi COVID-19 nga viti 2020 e këndej.

ISHP "Laor" Tetovë nuk i dorëzon çmimoret e kërkuara, por dorëzon vetëm informacion se ISHP "Laor" Tetovë ka miratuar çmimore në pajtim me të cilat i jep shërbimet shëndetësore dhe të cilat janë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive, pa dorëzuar kopje të të njëjtave.

Me konkluzionin, qartë kërkohet të dorëzohen të dhëna për të hyrat e realizuara gjithsej nga testimet për infeksion nga korona virusi COVID-19 për vitin 2020, 2021 dhe për periudhën janar - shkurt 2022 veçmas dhe veçmas sipas llojeve të testeve.

ISHP "Laor" Tetovë nuk i dorëzoi të dhënat e kërkuara, por dorëzoi shpjegim se të hyrat e realizuara gjithsej të ISHP Laor Tetovë janë të dhëna publike të cilat mund të sigurohen nga Regjistri Qendror, si dhe të hyrat e realizuara lidhur me testimet për Covid-19, por se nuk ekziston mundësi që të ndahen për arsye se nga ana e pacientëve mund të kryhen shërbime të ndryshme shëndetësore dhe të njëjtat të paguhën në mënyrë të kompletuar d.m.th. në grup.

Me konkluzionin, qartë kërkohet të dorëzohen të dhëna për atë se nga kush janë kryer furnizimet e testeve për testim për infeksion nga korona virusi COVID-19.

ISHP "Laor" Tetovë nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara por vetëm thekson se testet për testim për infeksion nga Covid-19, ISHP "Laor" Tetovë i furnizon nga shumica e depove farmaceutike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sekretari i Përgjithshëm nga më shumë se 15 subjekte i kërkoi të dhënat e njëjta me qëllim që ta kryejë hulumtimin e theksuar dhe plotësisht u dorëzuan të dhënat e kërkuara nga 15 institucione shëndetësore që kryejnë teste për infeksion nga korona virusi COVID-19.

Duke marrë parasysh faktin se ISHP "Laor" Tetovë ka dorëzuar të dhëna jo të plota lidhur me konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022, KVK, në seancën e mbajtur më datë

02.02.2023, solli konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtëse PK.nr.09-9/1, me të cilin kërkoi nga ISHP "Laor" Tetovë t'i dorëzojë të dhënat dhe dokumentet në vijim: ekstrakt nga Regjistri Qendror për gjendjen rrjedhëse, bilancin e suksesit për vitin 2021 dhe të dhëna për xhiro-llogarinë dhe bankën depozituese.

Me letër shoqëruese PK.nr.09-9/2 më datë 21.02.2023, konkluzioni i theksuar iu dorëzua ISHP "Laor" Tetovë.

Në seancën e mbajtur më datë 06.06.2024, KVK solli njoftim paraprak për gjendjen faktike të konstatuar, PK.nr.09-25/1. Me letër shoqëruese PK.nr.09-25/1, më datë 06.06.2024, njoftimi paraprak i theksuar për gjendjen faktike të konstatuar iu dorëzua ISHP "Laor" Tetovë.

Në seancën e mbajtur më datë 31.01.2025, KVK solli njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar, PK.nr.09-6/1. Me letër shoqëruese PK.nr.09-6/2, më datë 31.01.2025, njoftimi përfundimtar i theksuar për gjendjen faktike të konstatuar iu dorëzua ISHP "Laor" Tetovë.

Më datë 07.02.2025, në hapësirat e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me kërkesë të ISHP "Laor" Tetovë, u mbajt takim, në të cilin morën pjesë kryetari dhe një anëtar i Komisionit për vendimmarrje për kundërvajtje, si dhe një përfaqësues nga shërbimi profesional, të cilët dhanë shpjegim të detajuar lidhur me nevojën që ISHP "Laor" Tetovë t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara me Konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022.

Më datë 11.02.2025, ISHP "Laor" Tetovë përmes të autorizuarit të tij Avokat Trajçe Sazdov, dorëzoi deri te KVK, deklarin me shkrim lidhur me njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar. Në shtojcë të deklaramit të theksuar, u dorëzuan të gjitha të dhënat dhe dokumentet e kërkuara me Konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022. Njëkohësisht, me deklarin, për herë të parë gjatë procedurës, u dorëzua edhe prokura me të cilën ISHP "Laor" Tetovë e autorizoi Avokatin Trajçe Sazdov, që në emër të tij dhe për llogari të tij ta përfaqësojë të njëjtin në procedurën para KMK-KVK.

Pas sigurimit të të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme, duke pasur parasysh të gjithë rrjedhën e procedurës, si dhe deklarin e palës në procedurë, KVK e konstatoi gjendjen faktike si vijon:

ISHP "Laor" Tetovë, me shkresën nr. 07-29/20 të datës 15.04.2022, përmes të autorizuarit të tij, avokatit Trajçe Sazdov, ka dorëzuar të dhëna jo të plota gjatë veprimit sipas konkluzionit PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm, dhe në kuptim të nenit 48 të LMK-së, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së.

Pas takimit të mbajtur në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ISHP "Laor" Tetovë në shtojcë të deklaramit të tij me shkrim lidhur me njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar i dorëzoi të gjitha të dhënat dhe dokumentet e kërkuara me Konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në pajtim me nenin 61 paragrafi (1) të LMK-së, KVK ndërmarrjes, respektivisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në shumë deri në 1% të vlerës së të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në shumë absolute dhe nominale për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore nëse:

dorëzon të dhëna të pasakta, jo të plota ose të cilat mund ta sjellin në lajthitje Komisionin ose Komisionin për vendimmarrje për kundërvajtje, dhe në kuptim të nenit 40, nenit 48 dhe nenit 49 të këtij ligji;

Gjatë përcaktimit të shumës së gjobës, në pajtim me nenin 64 të LMK-së, KVK do t'i marrë parasysh peshën e kundërvajtjes, kohëzgjatjen e kundërvajtjes dhe shkallën e cenimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Duke marrë parasysh faktin se gjatë procedurës, pas dorëzimit të Njoftimit përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar, ISHP "Laor" Tetovë në tërësi i dorëzoi të dhënat e kërkuara me Konkluzionin PK.nr.07-29/2 të datës 03.03.2022 të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, KVK, gjatë matjes së gjobës vendosi të zbatojë nenin 64 paragrafi (4), me ç'rast shumën e gjobës të përcaktuar në Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar, vendosi ta zvogëlojë, duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese, respektivisht duke pasur parasysh faktin e lartpërmendur se ISHP "Laor" Tetovë në tërësi i dorëzoi të kërkuarat e kërkuara.

Në pajtim me të dhënat dhe dokumentet e dorëzuara në përgjigjen ndaj Njoftimit përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar gjatë përcaktimit të shumës së gjobës e cila i shqiptohet ISHP "Laor" Tetovë, KVK niset nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të ISHP "Laor" Tetovë, përkatësisht të realizuara në vitin 2023, si viti i fundit afarist për të cilin ISHP "Laor" Tetovë ka përpiluar llogari vjetore, respektivisht 23.083.177 denarë.

Duke pasur parasysh peshën e kundërvajtjes, shkallën e cenimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja, KVK shumën bazë të gjobës e përcakton në lartësi prej 0.26%, prandaj shuma bazë e gjobës arrin 60.000,00 denarë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare, me konkluzionin PK.nr.09-9/1 të datës 02.02.2023, kundër ISHP "Laor" Tetovë, me seli në rr. "29 Nëntori" nr. 21-1 Përdhes/Lok1, 2 dhe 3, Tetovë, e përfaqësuar nga i autorizuari Avokat Trajçe Sazdov, për shkak të kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, **KVK konstatoi se ISHP "Laor" Tetovë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 2) të LMK-së.**

Për shkak të të gjitha të lartpërmendurave KVK vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски